



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 25.05.2012 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj

Mungon: Glauk Konjufca, Petar Miletic dhe Mufera Sinik.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësues nga zyra e ICO-së Dejan Cosic, Siv.K, përfaqësues nga zyra e USAID-it, Markovic Branislav, z. Brian. Z. Gëzim, përfaqësues nga ambasada US (Amerikane) Andrea Tomaslevic, përfaqësues nga zyra e ZPRK Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtime nr. 04/L-110, me raportin e Komisionit, funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, me amendamente**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtime nr. 04/L-110, me raportin e Komisionit, funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, me amendamente.

Kryesuesi – Theksoi se kjo pike është urgjente sepse do të rradhitet në mbledhje të radhës për Kuvend.

Kryesuesi – paraqiti për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për Ndërtime nr.04/L-110, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I.Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Ndërtime nr.04/L-110 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve

II .Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic